



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	05.10.2012
PËR/ZA/TO:	z. Shefik Fazliu Drejtor i Zyrës i Prokurimit në Komunën e Mitrovicës.
CC:	z. Avni Kastrati Kryetar i Komunës së Mitrovicës.
NGA/OD/FROM:	<i>na</i> z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin “Krijimi i Kadastrit të Përçojave dhe Objekteve Nëntokësore”



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin “ Krijimi i Kadastrit të Përçojave dhe Objekteve Nëntokësore ” me nr. prokurimit 642-12-112-221 ofron këtë:

OPINION

Kërkohej nga ju autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Krijimi i Kadastrit të Përçojave dhe Objekteve Nëntokësore” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Zyra e prokurimit në Komunën e Mitrovicës, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit “Shërbime” të procedurës së hapur me nr. të prokurimit 642-12-112-221 me titull “Krijimi i Kadastrit të Përçojave dhe Objekteve Nëntokësore” në Mitrovicë , në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit te neni 9.1 i Dosjes së tenderit te kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale pika 1,3,5 dhe 6 Dokumentet e Kërkuara – ka kërkuar , veç tjerash:

- Lista e projekteve të realizuara në tri vitet e fundit (Referenca apo kontrata të realizuara të kësaj natyre).

- Plani dinamik i punës sipas detyrave të projektit.
- Specifikimi i pajisjeve për kryerjen e punëve sipas specifikacionit : GPS, Stacione Totale, Harduerë, Softuer Gjeodezik për barazim adekuat të rrjetit, Pajisje për detektim të për çojave nëntokësore (dëshmi mbi pronësinë dhe certifikimin).
- Lista e stafit, së paku :
 - Një (1) Menaxher – të jetë Gjeodet i Diplomuar,
 - Dy (2) Inxhinier të Gjeodezisë
 - Një (1) Inxhinier të Energjetikës (Ose Telekomunikacionit)
 - Një (1) Inxhinier të Hidroteknikës (ose Ndërtimtarisë).

Zyra e prokurimit këto kërkesa i ka shpalosur edhe njëherë duke i zbërthyer në kuadër të Aneksit 6 Kriteret për Dhënien e Kontratës të pikës 2,3,4 dhe 5 tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ku ka paraparë:

- ❖ “Referencat ” - pesha e këtij nën kriteri është 15 % të poentimit,
- ❖ “ Plani dinamik ” - pesha e këtij nën kriteri është 10% të poentimit.
- ❖ “ Staf ” - pesha e këtij nën kriteri është 15 % të poentimit,
- ❖ “Pajisjet” - pesha e këtij nën kriteri është 10% të poentimit.

Me aktin e këtillë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin nr.04/L-042 të Prokurimit Publik konkretisht këto dispozita:

- Dispozitën e nenit **52.4 të LPP-së 04/L-042**

Me respekt!